



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:106013

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05411483

E.nr.547/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit B.B. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit QKMF - Ferizaj, për pagesën e pagës jubilarë dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 04.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.547/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.547/23, të datës 23.03.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit QKMF Ferizaj, për pagesën e pagës jubilarë dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të ujdisë gjyqësore C.nr.1150/21, të datës 28.09.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 15.09.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,400.50 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.547/23, më datë 04.03.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi